



Buletini mujor

Maj 2026



Kryetari i KLSH-së, z. Arben Shehu, zhvilloi takime të hapura me studentë dhe pedagogë në kuadër të përvjetorit të institucionit

Në kuadër të aktivitetit “Ditët e Hapura” dhe përvjetorit të themelimit të institucionit, Kryetari dhe stafi i Kontrollit të Lartë të Shtetit, në datat 20-22 maj 2026 mirëpritën në takime të hapura studentë dhe pedagogë të fakulteteve të Drejtësisë, Ekonomisë dhe Inxhinierisë së Ndërtimit.

Në takimën me studentët e Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Tiranës morën pjesë edhe Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. Ilir Rusi, si dhe Dekania e Fakultetit të Drejtësisë, znj. Dorina Hoxha.

Gjatë bashkëbisedimit me studentët, z. Shehu u ndal te rrugëtimi institucional, përgjegjësitë dhe misioni që KLSH ka mbajtur ndër vite në shërbim të interesit publik, ligjshmërisë, transparencës dhe forcimit të llogaridhënies në administrimin e financave publike.

Kryetari i KLSH-së vlerësoi rëndësinë e dialogut të vazhdueshëm ndërmjet institucioneve publike, sistemit të drejtësisë dhe botës akademike, në funksion të forcimit të shtetit të së drejtës.

Në vijim të takimit, z. Shehu dhe z. Rusi iu përgjigjën interesimit të studentëve lidhur me veprimtarinë institucionale, sfidat profesionale, si dhe mundësitë që institucionet ofrojnë për praktika profesionale dhe punësim pas diplomimit.

Më 21 maj 2026 u zhvillua takimi me studentët e Fakultetit të Ekonomisë të Universitetit të Tiranës.

Në këtë aktivitet ishin të pranishëm Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës Financiare, z. Ervin Koçi dhe Zv/Dekania e Fakultetit të Ekonomisë, Prof. Etleva Bajrami. Diskutimet u fokusuan në rolin dhe veprimtarinë e KLSH-së, si dhe në rëndësinë e transparencës dhe kontrollit të financave publike.

Takimet e hapura në KLSH vijuan me studentë dhe pedagogë të Universitetit Politeknik të Tiranës, si dhe me ekspertë të fushës së inxhinierisë dhe arkitekturës. Pjesë e kësaj tryeze ishte edhe z. Artan Shkrelly, si dhe përfaqësues nga Shoqata e Arkitektëve. Në takim u diskutua mbi problematikat e konstatuara në veprat e infrastrukturës publike dhe bashkëpunimin ndërmjet KLSH-së dhe Universitetit Politeknik mbi praktikën mësimore për studentët dhe trajtimin të çështjeve me interes të përbashkët.

Në përfundim, z. Shehu theksoi se Kontrolli i Lartë i Shtetit e konsideron mbështetjen e studentëve dhe ekselencës akademike jo vetëm si një përgjegjësi institucionale, por edhe si një investim të rëndësishëm për të ardhmen.

Kontrolli i Lartë i Shtetit, 101 vjet auditim publik

20 MAJ 1925 – 20 MAJ 2026



101

VJET
Në shërbim të
transparencës
dhe
llogaridhënies
publike

Kontrolli i Lartë i Shtetit

“Nga përvoja drejt inovacionit.”

 INTEGRITET Etikë, ndershmëri dhe profesionalizëm	 AUDITIM Transparencë dhe llogaridhënie	 BESIM PUBLIK Në shërbim të qytetarëve dhe interesit publik	 BASHKËPUNIM Partnerë vendas dhe ndërkombëtarë	 INOVACION Auditim përmes teknologjisë
---	---	---	--	--



Nga takimi me studentët e Fakultetit të Ekonomisë, Universiteti i Tiranës



Nga takimi me studentët Fakultetit të Drejtësisë, UT



Nga takimi me studentët dhe pedagogët e Universitetit Politeknik

Kryetari i KLSH-së, z. Arben Shehu, priti në takim delegacionin e Komisionit të Venecias



Më 28 maj 2026, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, z. Arben Shehu, së bashku me përfaqësues të institucionit, priti në një takim zyrtar delegacionin e Komisionit të Venecias, i cili zhvilloi një vizitë pune në Shqipëri gjatë periudhës 27-29 maj 2026. Vizita u realizua në kuadër të procesit të përgatitjes së opinionit të Komisionit të Venecias për projektligjin "Mbi financimin e partive politike".

Gjatë takimit të zhvilluar në ambientet e KLSH-së, palët diskutuan mbi rëndësinë e forcimit të transparencës, llogaridhënies dhe mekanizmave të kontrollit financiar, në përputhje me standardet evropiane dhe praktikat më të mira ndërkombëtare.

Përfaqësuesit e KLSH-së paraqitën eksperiencën institucionale në fushën e auditimit dhe kontrollit financiar, referuar mandatit kushtetues, si dhe vlerësimet mbi rëndësinë e një kuadri ligjor të qartë dhe efektiv për garantimin e integritetit të financimit politik. KLSH e konsideron të rëndësishëm bashkëpunimin dhe dialogun me institucionet dhe organizmat ndërkombëtare, duke e vlerësuar si një mundësi për shkëmbim përvojë dhe forcim të standardeve të transparencës dhe llogaridhënies.

Në këtë kuadër, institucioni mbetet i përkushtuar për të kontribuar në proceset që lidhen me forcimin e shtetit të së drejtës.

KLSH, në Takimin Vjetor të IBAN dhe Institucioneve Supreme të Auditimit të vendeve të NATO-s

U zhvillua më 21 maj 2026 në Qendrën e Konferencave të Selisë së NATO-s në Bruksel, Belgjikë, Takimi Vjetor ndërmjet Bordit Ndërkombëtar të Audituesve për NATO-n (IBAN) dhe Institucioneve Supreme të Auditimit të vendeve anëtare të NATO-s.

Në këtë aktivitet morën pjesë edhe dy përfaqësues të Kontrollit të Lartë të Shtetit, duke konfirmuar angazhimin e institucionit për forcimin e bashkëpunimit profesional dhe shkëmbimin e praktikave më të mira në fushën e auditimit publik dhe atij të mbrojtjes.



Gjatë sesioneve të punës u prezantuan raportet vjetore të aktivitetit të IBAN, auditime të performancës dhe raporte speciale mbi administrimin financiar dhe menaxhimin e burimeve në strukturat e NATO-s. Një vëmendje e veçantë iu kushtua auditimit të fondeve publike në situata krize dhe konflikti, si dhe rolit të Institucioneve Supreme të Auditimit në garantimin e transparencës, integritetit dhe llogaridhënies.

PROJEKTI GLOBAL MBI PAVARËSINË E SAI-ve IDI dhe OECD publikojnë raportin “Forcimi i pavarësisë së Institucioneve Supreme të Auditimit”

IDI: Në mbarë botën, pavarësia e Institucioneve Supreme të Auditimit (SAI) po përballlet me sfida në rritje dhe kjo çështje nuk lidhet vetëm me kuadrin ligjor formal.

Iniciativa për Zhvillim e INTOSAI-t (IDI) dhe Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD) publikuan më 27 maj 2026 raportin final mbi projektin global “Forcimi i pavarësisë së Institucioneve Supreme të Auditimit”. I mbështetur në Deklaratën e Meksikës të INTOSAI-t mbi “Pavarësinë e Institucioneve Supreme të Auditimit”, ky raport i përbashkët i IDI-t dhe OECD-së bën thirrje për një qasje gjithëpërfshirëse dhe sistemike ndaj pavarësisë së SAI-t dhe ofron udhëzime praktike dhe parime globale për të mbështetur një angazhim më të fortë ndërmjet ministrive të financave, parlamenteve dhe institucioneve të mbikëqyrjes.


PROJEKTI GLOBAL PËR PAVARËSINË E SAI-VE

Shpeshherë, rregullat e paqarta, kufizimet institucionale dhe dinamikat informale të pushtetit pengojnë SAI-t të ushtrjnë plotësisht mandatin e tyre kushtetues për të mbajtur qeveritë përgjegjëse për përdorimin e fondeve publike. Pikërisht për këtë arsye, IDI ka ndërmarrë Projektin Global për Pavarësinë e SAI-ve, me synimin për të identifikuar dhe evidentuar pengesat reale me të cilat përballen këto institucione, si dhe për të nxitur ndryshime të qëndrueshme. Ky projekt novator shkon përtej komunitetit të auditimit, duke përfshirë parlamentet, ekzekutivin dhe shoqërinë civile në zhvillimin e kërkimeve, hartimin e parimeve praktike dhe promovimin e advokimit të fuqishëm në mbështetje të pavarësisë institucionale.

SAI-t luajnë një rol jetik në mbikëqyrjen e performancës së qeverive dhe përdorimit të burimeve publike. Pavarësia e tyre është thelbësore për besueshmërinë dhe efektivitetin e tyre në shërbim të interesit publik. Megjithatë pavarësia e SAI-ve garantohet me ligj, në praktikë ajo ndikohet nga shumë faktorë informale. Këta faktorë ndikojnë në mënyrën se si SAI-t ndërveprojnë, marrin vendime dhe angazhohen me aktorët e tjerë brenda sistemit të llogaridhënies.

GJETJET KRYESORE

- SAI-t përballen me sfida ndaj pavarësisë së tyre kur nuk gëzojnë autonomi buxhetore, nuk kanë akses të plotë në informacion ose nuk mbrohen mjaftueshëm nga ndikimet e papërshtatshme.
- Pavarësia e SAI-t formësohet jo vetëm nga kuadri ligjor, por edhe nga faktorë informale, si marrëdhëniet me aktorët e tjerë institucionalë, reputacioni, dinamika politike dhe normat profesionale.
- Besimi ndaj SAI-t përbën një bazë themelore për mbrojtjen e pavarësisë së tij. Aktorët e interesit kanë më shumë gjasa të vazhdojnë ta mbështesin një SAI që gëzon reputacion të besueshëm, të drejtë dhe legjitim.
- SAI-t që njihen për transparencë, efektivitet, paanshmëri dhe integritet në rezultatet që ofrojnë, kanë më shumë mundësi të arrijnë rezultate më të mira në forcimin e llogaridhënies dhe mbikëqyrjes publike.



REKOMANDIMET

Raporti “Forcimi i Pavarësisë së Institucioneve Supreme të Auditimit” bën thirrje për një qasje gjithëpërfshirëse dhe në të gjithë sistemin ndaj pavarësisë së Institucioneve Supreme të Auditimit (SAI).

Kjo përfshin:

- Forcimin e dispozitave ligjore.
- Përmirësimin e praktikave institucionale.
- Rritjen e koordinimit ndërmjet palëve të interesit.
- Nxitjen dhe konsolidimin e besimit.
- Pavarësia e SAI-ve është një rezultat dinamik, i formësuar nga institucionet, marrëdhëniet dhe niveli i besimit që ato gëzojnë.
- OECD dhe IDI rekomandojnë që, për të rritur qëndrueshmërinë, besueshmërinë dhe ndikimin e SAI-ve, duhet të trajtohen njëkohësisht si dimensionet formale ashtu edhe ato informale të pavarësisë.



EUROSAI VJEN NË TIRANË

SHQIPËRIA MIRËPRET AUDITUESIT E RINJ TË EVROPËS



Kontrolli i Lartë i Shtetit pret për herë të parë konferencën ndërkombëtare të audituesve të rinj “Young EUROSAI (YES) 2026”



Edicioni i 7-të i Konferencës Young EUROSAI (YES), një iniciativë e Organizatës Evropiane të Institucioneve Supreme të Auditimit (EUROSAI) do të zhvillohet në datat 9–10 qershor 2026 në Tiranë.



Tema kryesore e konferencës do të jetë “*Auditues të përgatitur për të ardhmen: Nxitës të ndryshimit në një botë digjitale dhe të qëndrueshme.*”



Konferenca Young EUROSAI është një forum që mbledh auditues të rinj nga Institucionet Supreme të Auditimit në Evropë, me qëllim shkëmbimin e përvojave, ideve inovative dhe praktikave më të mira në auditimin publik.



YOUNG EUROSAI (YES) 2026

TIRANË, 9–10 QERSHOR 2026

RRUGËTIMI I YOUNG EUROSAI 2013-2026

YOUNG EUROSAI I

YES 2013

Konferenca u mbajt më 21-22 nëntor 2013 në Rotterdam, Holandë. Tema e konferencës ishte "Inovacioni dhe sfidat që ndeshin SAI-t". Morën pjesë rreth 150 auditues nga SAI-t evropiane.



YOUNG EUROSAI II

YES 2015

Konferenca u mbajt më 9-12 tetor 2015 në Jeruzalem, Izrael. Tema e konferencës ishte "SAI & Unë". Morën pjesë 77 auditues të rinj nga 40 SAI.



YOUNG EUROSAI III

YES 2017

Konferenca u mbajt më 11-14 shtator 2017 në Tallin, Estoni. Tema e konferencës ishte "Përditësimet gjithmonë të aksesueshme". Morën pjesë rreth 100 auditues të rinj nga 40 SAI.



YOUNG EUROSAI IV

YES 2019

Konferenca u mbajt më 4-7 nëntor 2019 në Londër, Mbretëri e Bashkuar. Tema e konferencës ishte "Si SAI-t mund të jenë të rëndësishme ndaj audiencave të tyre". Morën pjesë rreth 79 auditues të rinj nga 39 SAI.

YOUNG EUROSAI V

YES 2022

Konferenca u mbajt më 12-15 shtator 2022 në Stokholm, Suedi. Tema e konferencës ishte "Kultura eksperimentale". Morën pjesë 90 auditues nga 40 SAI.



YOUNG EUROSAI VI

YES 2024

Konferenca u mbajt më 25-27 qershor 2024 në Varshavë, Poloni. Tema e konferencës ishte "Po AI". Morën pjesë 42 auditues nga 34 SAI.

YOUNG EUROSAI VII








YES 2026

Konferenca do të mbahet në Tiranë më 9-10 qershor 2026. Tema e konferencës është "Auditues të përgatitur për të ardhmen: Nxitës të ndryshimit në një botë digjitale dhe të qëndrueshme."



Falënderit për leximin!

© Të gjitha të drejtat e rezervuara nga KLSH

 www.klsh.org.al	 Kontrolli i Lartë i Shtetit
 E-mail: klsh@klsh.org.al info@klsh.org.al	 klsh_org_al
 Rruga "Abdi Toptani" Nr.1 Tiranë	 (KLSH) Albanian Supreme Audit Institution
	 Orari pritjeve për publikun: E hënë – E enjte: 08:00 – 16:30 E premte: 08:00 – 14:00